



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 45 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0296731/18 18.12.2018, të pronarit Gani Bajrami nga Prishtina, dhe investitorit “IN TIME” shpk, me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Burim Bajraktari nga Suhareka, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të tërësisë urbane “A12”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër”, në rr. “Malush Kosova” hyrjet 82, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 21.12.2018, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarit Gani Bajrami nga Prishtina, dhe investitorit “IN TIME” shpk, me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Burim Bajraktari nga Suhareka, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0296731/18 18.12.2018, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+4+Nk, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-155470 dt.18.08.2016, në parcelën kadastrale nr. 1568-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 943-2, 944-3, 944-4 dhe 944-5), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01568-0 ZK Matičan, konkretisht në kuadër të tërësisë urbane “A12”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, e ndërtuar në rrugën “Malush Kosova” hyrjet 82, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Gani Bajrami nga Prishtina, me investitor “IN TIME” shpk nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-0296731/18 18.12.2018, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet B+P+4+Nk, e ndërtuar në kuadër të tërësisë urbane “A12”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1568-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 943-2, 944-3, 944-4 dhe 944-5 ZK Prishtinë), ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-155470 dt.18.08.2016 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprkisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresës zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-0266992/17 dt. 16.12.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit Final, 09 Nr. 356-226246 dt. 06.12.2018, të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës si dhe Inspektimin Final të dt. 06.12.2018, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Ibsoektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Kopjet e diplomave të inxhinierëve; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi i.d.a. Përparim Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi i.d.n. Halim Bajramaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi i.d.h. Nexhmedin Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi i.d.e. Skender Rugovaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi i.d.m. Bajram Mustafa; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Gorçaj me nr. të licensës 94;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-0296731/18 DT. 21.12.2018**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Lindita Beqiri

L. Beqiri

Drejtori,
Ardian Olluri

